STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 15 mars 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON RIMBURSIMIN PREJ 4 MILIONE DOLLARE PER QARKUN SAFOLK (SUFFOLK COUNTY) PER KOSTOT E SUPER STUHISE SENDI (SANDY)

Guvernatori drejton fonde të miratuara federalisht të Ndihmës Publike për kostot e pastrimit dhe heqjes së mbeturinave pas super stuhisë Sendi (Sandy)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Kuomo) njoftoi sot se Shteti i Nju Jorkut (New York State) ka siguruar 4,023,035 milionë dollarë për Qarkun Safolk (Suffolk County) për rimbursimin e kostove të heqjes së mbeturinave të pësuara nga qarku pas pasojave të super stuhisë Sendi (Sandy). Qarku Safolk (Suffolk County) pati pemë dhe bimë të tjera të dëmtuara rëndë, duke lënë rreth 348,372 jardë kub mbeturina në rrugët e qarkut, kalimet, parqet dhe hapësirat e tjera publike. Qarku reagoi duke kombinuar personelin e fshatit, pajisjet dhe disa kontrata të jashtme. Kontratat u përdorën për pastrimin e mbeturinave, heqjen e pemëve, heqjen e mbeturinave nga kopshtet dhe transportimin e mbeturinave në vendin e eleminimit.

“Ndikimi i Sendit (Sandy) ishte shkatërrues për çdo komunitet në rrugën e tij dhe Qarku Safolk (Suffolk County) pësoi dëmtim të pashembullt, duke lënë mbeturina të stuhisë anembanë qarkut,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Si kaq shumë komuniteteve të tjera të prekura, Qarkut Safolk (Suffolk County) iu desh të hiqte sasi të mëdha të mbeturinave, që vazhdojnë të bëjë muaj pasi stuhia gjëmoi anembanë fshatrave, qytezave dhe qyteteve të tij. Ky rimbursim është mes shumë prej tyre që Qarku Safolk (Suffolk County) dhe komunitetet e tjera të prekura do të marrin, të miratuara nga shteti, nga qeveria federale. Jam shumë i gëzuar të jem në gjendje që të drejtoj këto fonde përseri tek Qarku Safolk (Suffolk County) dhe t’i ndihmoj ata të vazhdojnë në përpjekjet e tyre të përgjithshme për rimëkëmbje.”

Nëpunësi i Qarkut Safolk (Suffolk County) Stiv Bellone (Steve Bellone) tha, “Ndikimi i super stuhisë Sendi (Sandy) u ndje anembanë Qarkut Safolk (Suffolk County), duke lënë qindra e mijëra mbeturina të pemëve në rrugë dhe prona publike e private. Guvernatori Kuomo (Cuomo) na ka ndenjur pranë gjatë gjithë këtij procesi të vështirë pas stuhisë dhe e falënderoj që na ndihmon përsëri duke drejtuar këto fonde mjaft të rëndësishme të rimbursimit në arkat e qarkut tonë.”

Senatori Keneth LaVale (Kenneth LaValle) tha, “Të gjithë ishim të tronditur nga sasia e dëmit që super stuhia Sendi (Sandy) shkaktoi në qarkun, qytezat dhe fshtrat tona. Ndërsa ka shumë për t’u bërë, ndihma e FEMA-s që po jepet për pastrimin do të ketë shumë ndikim në ndihmën për punën për rimëkëmbjen që po bëhet.”

Senatori Karl Merçelino (Carl Marcellino) tha, “Jam mirënjohës që qarku po merr këto fonde vendimtare, duke siguruar se taksapaguesit e Safolkut (Suffolk) nuk do të marrin përsipër barrën e plotë të kostove pas super stuhisë Sendi (Sandy). Ky është një hap i rëndësishëm ndërsa vazhdojmë të rimëkëmbemi dhe të rindërtojmë.”

Senatori Çarls J. Fushilo Jr. (Charles J. Fuschillo, Jr.) tha, “Supër stuhia Sendi (Sandy) shkaktoi një shkatërrim dhe dëm të madh anembanë Qarkut Safolk (Suffolk County). Qarku shpenzoi burime të konsiderueshme për të hequr mbeturinat e stuhisë, në mënyrë që komunitetet të mund të fillonin rimëkëmbjen dhe rindërtimin sa më shpejt që të ishte e mundur. Dhënia e këtyre fondeve të rimbursimit tek Qarku Safolk (Suffolk County) do të ndihmojë në sigurimin e mbështetjes mjaft të nevojshme për përpjekjet e vazhdueshme të rimëkëmbjes së tij.”

Senatori Malkom Smith (Malcolm Smith), Bashkë-Kryetar i Forcës së Posatçme Tre-palëshe të Senatit të Shtetit të Nju Jorkut për Rimëkëmbjen nga Uragani Sendi (New York State Senate's Bipartisan Task Force on Hurricane Sandy Recovery) tha, “Në ditët pasi Sendi (Sandy) goditi fillimisht, Qarku Safolk (Suffolk County) drejtoi burime të jashtëzakonshme drejt përpjekjeve të pastrimit dhe riparimit në komunitetet vendore. Në nivelin federal dhe shtetëror, e çmojmë vlerën e atyre investimeve të shpejta. Prandaj jemi duke bërë gjithshka që mundemi për të ndihmuar autoritetet e qarqeve.”

Udhëheqësja e Konferencës Demokratike të Senatit (Senate Democratic Conference Leader) Andrea Stjuart-Kanzëns (Andrea Stewart-Cousins) tha, “Një nga forcat tona më të mëdha si banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) është se kur katastrofa godasin këtë shtet, bashkohemi dhe ndihmojmë fqinjët tanë që të rimëkëmben dhe të rindërtojnë. Përgëzoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për udhëheqjen dhe përkushtimin e tij ndaj të gjithë banorëve të Nju Jorkut (New Yorkers) që vuajtën si rezultat i super stuhisë Sendi (Sandy) dhe për të siguruar se ky rimbursim do t’i jepet Qarkut Safolk (Suffolk County). Si shtet kemi parë se kur bashkohemi dhe punojmë për të mirën e përbashkët pas këtyre katastrofave, jo vetëm rindërojmë, por rindërtojmë më fuqishëm dhe të përgatitur më mirë për të ardhmen.”

Senatori Li M. Zeldin (Lee M. Zeldin) tha, “Dhënia e këtij fondi është një lajm i mirë për Qarkun Safolk (Suffolk County). Pasi goditi Sendi (Sandy), komunat tona filluan detyrën e shtrenjtë dhe që kërkon shumë kohë të pastrimit të pemëve të rrëzuara dhe materialeve të rrezikshme, mes shumë përgjegjësive të tjera. Kishte kosto masive të pastrimit për buxhetet e qarkut, qytezës dhe fshatit, që mund të kishin rezultuar edhe në një barrë tjetër për taksapaguesit vendorë pa ndihmën nga Kongresi. Jam veçanërisht mirënjohës për përpjekjen e suksesshme të Guvernatorit Kuomo (Cuomo) për të ndikuar në udhëheqjen e Kongresit dhe të Shtëpisë së Bardhë (White House). Kjo ndihmë është vendimtare ndërsa vazhdojmë të rimëkëmbemi.”

Senatori Fill Boil (Phil Boyle) tha, “Pastrimi i mbeturinave të lëna nga Sendi ishte një sipërmarrje urgjente për sigurinë dhe shëndetin publik, duke kërkuar përpjekje masive të kombinuara të punës dhe pajisjeve. Përgëzoj dhënien e fondeve federale nga Guvernatori Kuomo (Cuomo) për të rimbursuar Qarkun Safolk (Suffolk County) për këto shpenzime të papritura dhe jam i gëzuar që këto fonde do të vazhdojnë të vijnë ndërsa përpjekjet e pastrimit vazhdojnë.”

Anëtari i asamblesë Bob Suini (Bob Sweeney) tha, “Ky fond është mjaft i rëndësishëm për komunitetin tonë, pasi familjet vendase vazhdojnë të bëjnë përpjekje për të rindërtuar shtëpitë dhe bizneset e tyre. Autoritetet tona vendore kanë qënë një partner thelbësor në këto përpjekje për t’a lënë pas këtë shkatërrim dhe për të mbrojtur komunitetin tonë nga dëmtimi nga katastrofa natyrorë në të ardhmen. Ky rimbursim do të ndihmojë në këto përpjekje.”

Anëtari i asamblesë Stiv Engëlbrajt (Steve Englebright) tha, “Pas stuhisë, banorët tanë u përballën më dëm të konsiderueshëm dhe detyrën e frikshme të heqjes së mbeturinave. Autoritetet tona vendore ofruan ndihmë, por pësuan shpenzime të konsiderueshme. Ky fond është vendimtar për të siguruar se ato kosto nuk u kalohen taksapaguesve të pronave tashmë të mbingarkuar. Do të dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për ata në Qarkun Safolk (Suffolk County) që iu përgjigjën super stuhisë Sendi (Sandy) dhe për Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për vendosjen e këtij fondi në dispozicion të komuniteteve tona për të ndihmuar në rimëkëmbjen e tyre nga pasojat e stuhisë.”

Anëtari i asamblesë Fred Thiele tha, “Super stuhia Sendi (Sandy) shkaktoi dëm të patregueshëm në komunitetin e Qarkut Safolk (Suffolk County). Jam i gëzuar që më në fund jemi në gjendje të sigurojnë ndihmën thelbësore financiare që do të na ndihmojë në përpjekjet tona për të rindërtuar.”

Anëtari i asamblesë Fil Ramos (Phil Ramos) tha, “Kaq shumë nga pronarët tanë të shtëpive dhe bizneseve që punojnë mjaft janë tashmë të mbingarkuar nga kostot për të hequr mbeturinat dhe për të rindërtuar. Ky fond është i rëndësishëm për përpjekjet tona të vazhdueshme për të rikthyer komunitetin tonë dhe për të siguruar se shërbimet vendimtare të siguruara nga autoritetet tona vendore nuk vihen në rrezik për shkak të kostove të paparashikuara si rezultat i stuhisë.”

Anëtari i asamblesë Majkëll Ficpatrik (Michael Fitzpatrick) tha, “Kjo ndihmë nevojitet mjaft dhe sigurisht do të vihet në përdorim të mirë, ndërsa Qarku Safolk (Suffolk County) vazhdon të rimëkëmbet nga pasojat shkatërruese të super stuhisë Sendi (Sandy). Vlerësoj ndihmën e Guvernatorit për të siguruar se këto fonde vendimtare shpërndahen për të siguruar që përpjekjet e pastrimit të shkojnë përpara.”

Anëtari i asamblesë Endrju Raia (Andrew Raia) tha, “Pas vështirësive që iu desh të përballonin banorët e Long Ajlënd (Long Islanders) pas super stuhisë Sendi (Sandy), është e shkëlqyeshme të shohim më në fund ndihmë të konsiderueshme që vjen nga Uashingtoni (Washington). Dëshiroj të përgëzoj Guvernatorin për punën e madhe duke luftuar nëpërmjet prirjeve politike që ekzistojnë në nivelin federal për t’u siguruar familjeve të Qarkut Safolk (Suffolk County) ndihmën që u është nevojitur që nga fillimi.”

Albanian

Anëtari i asamblesë Al Graf tha, “Përgëzoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) dhe Anëtarin e kongresit King për përkushtimin e tyre ndaj popullit të Long Ajlënd (Long Island), në sigurimin e fondeve për pastrimin e mbeturinave të lëna nga super stuhia Sendi (Sandy). Jam i sigurtë se janë duke vazhduar luftën për të siguruar fondet e nevojshme për lehtësimin; sidomos ato të nevojitura për të mbyllur të çarat në Fajër Ajlënd (Fire Island) që janë duke shkatërruar vijat tona bregdetare të pjesës tokësore.”

Anëtari i asamblesë Eduard Henesi (Edward Hennessey) tha, “Ky rimbursim është vendimtar në sigurimin se taksapaguesit e Qarkut Safolk (Suffolk County) nuk janë të ngarkuar plotësisht me koston e pastrimit nga super stuhia Sendi (Sandy). Do të vazhdoj luftën për t’u siguruar se komunitetet tona marrin ndihmën shtetërore dhe federale të nevojshme për t’u rimëkëmbur dhe rindërtuar plotësisht.”

Anëtari i asamblesë Endrju Garbarino (Andrew Garbarino) tha, “Këto katër milionë dollarë janë një fillim i mirë për të ndihmuar Safolkun (Suffolk) për paratë që harxhoi duke u pastruar nga super stuhia Sendi (Sandy). Mezi pres që të punojmë më Guvernatorin për t’u siguruar se Long Ajlënd (Long Island) kthehet në gjendjen e tij përpara Sendit (Sandy).”

Anëtari i asamblesë Çed Lupinaçi (Chad Lupinacci) tha, “Komuniteti ynë ka treguar një shpirt të qëndrueshëm pas super stuhisë Sendi (Sandy). Përpjekjet e kryera nga agjencitë tona vendore, organizatat e ndihmës dhe banorët kanë qënë dhe mbeten me të vërtetë të jashtëzakonshme. Vala e ndihmës së sotme do të lejojë komunitetin tone që të vazhdojë procesin e rimëkëmbjes ndërsa punojmë për të rikthyer një ndjenjë të plotë normaliteti. Dëshiroj të falënderoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) dhe të gjithë përfaqësuesit tanë federalë për përpjekjet e tyre dhe shfaqjen e fortë të mbështetjes në kohën tonë të nevojës.”

Dhënia e këtyre fondeve federale është pjesë e rimbursimeve në vazhdim dhe në pritje në të ardhmen që shteti do të administrojë dhe paguajë tek komunat e prekura. Komunat janë duke u rimbursuar mbështetur në një shumëllojshmëri projektesh që përfshijnë ndërtimin dhe shkatërrimin, heqjen e mbeturinave ranore dhe bimore, aktivizime të EOC-së, largime, kontrolle dhe riparime dhe rivendosje emergjente të teknologjisë së informacionit dhe programin Strehimi dhe Energjia Thelbësore e Përkohëshme (Sheltering and Temporary Essential Power) (STEP). Shteti do të vazhdojë t’i bëjë këto pagesa të rimbursimeve ndërsa FEMA jep fondet.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418